Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1114/20
Datë/Datum. 28-12-2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Kastrati	18.12.2020	28.12.2020	1114/20
Emri dhe Mbiemri i ekspertit shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.12.2020, OE "N.T.SH. Atom - Med" - FERIZAJ, ka parashtruar ankesë me nr: 1114/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim emergjent me reagenca për D-Dimer" me nr. të prokurimit: 616-20-8077-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 115,000.000 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Neni 1 i LPP-se

Neni 6 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 51 i LPP-se

Neni 4.1 i RRUOPP

Neni 4.4 i RRUOPP

Neni 18.9 i RRUOPP

Neni 26 i RRUOPP

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Pretendimet tona ankimore janë për *"Furnizim emergjent me reagenca per D-DIMER"*
Te nderuar. Ju njoftojme se :Kuvendi Komunal Prishtine me dt. 10.12.2020, kete aktivitet te prokurimit e ka publikuar Njoftimin per Kontrate ne platformen elektronike, me ç'rast ne jemi te interesuar qe te ofertojmë, por e kemi te pamundur ngase kemi hasur ne kritere te perzgjedhjes te cilat jane diskriminuese dhe favorizuese, konkretisht te kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale sa i përket Kërkesës nr"
2-Operatori ekonomik duhet te angazhoj personelin professional te cilet duhet te kene kualifikime shkollore a) Nje specialist te trajnuar per montim dhe venie ne funksion te aparatures per D-Dimer, b) Nje inxhinier te trajtuar per servisim te aparatures per D-Dimer.

Kerkesa jone ka te beje me keto 2 pika ku:
Ne rast se paisja per te cilat kane kerkuar teste per furnizim Emergjent ekziston ne Qendren e Mjeksis Familiare dhe eshte i fuksionalizuar, atehere eshte dashur qe te shenohet paisja dhe most e krijohet konfuzion me shume me kerkesa e vendime te parandesishme HERDOO2 e kritere te servisimit

Ne nuk pajtohemi me shpjegimin dhe arsyet qe keni potencuar ne nje procedur per blerje mallra sherbime.

Ne e njofim shum mire paisjen dhe si e tille eshte nder paisjet me te thjeshta per perdorim.

Poashtu kalibrimi dhe kontrolla per reagjent, ne kete rast D-Dimer, nuk beltet nga inxhinjeret e servisit por behet nga vete aplikantet (Biokimist dhe laborant) dhe eshte pjes aplikative. Kalibrimi dhe kontrolli i paisjes (jo i reagjenteve) eshte pjes e servisit the mirmbajtjes e cila duhet ti atribohet nje kontrate tjeter per servisim dhe mirmbajtje.

Qellimi ne kete rast eshte te krijohen bariera per aplikuesit tjere ne kete procedur tenderimi dhe pamundesin e nje pjesmarrje te barabart me kritere aspak komform natyres se furnizimit, duke pas parasysh se autorizimet per servis posedon vetem nje OE, dhe kjo eshte kontrate furnizimi jo SERVISI.

Duke u thirr ne emer te qytetareve dhe shendetit te tyre, nuk mund te perdoren kritere diskriminuese dhe duhet te ruhet bugjeti i Komunes.

VIDAS PC eshte total sistem i mbyllur, nuk lejon asnje nderhyrje, asnje reagjent kompatibil por vetem origjinal, dhe kjo garanton ne menyre APSOLUTE cilesi nga secili qe ofron D-Dimer Vidas. Kemi vetem nje prodhues ne bote dhe paisja pranon 1 lloj reagjenti me barkode.

Kalibirimi dhe kontrolla jan te perfshira mbrenda kitit dhe kjo behet vetem nga aplikuesit por jo edhe nga lnxhinjeret e serviseret.

Te hiqen kritere diskriminuese, INXHINJER DHE SPECIALIST I AUTORIZUAR PER SERVISIM TE APARATURES, te lejohet pjesmarrja e barabart per produktin e vetem ne treg D-Dimer VIDAS PC.

Komuna e Prishtines na ka pamundesuar pjesemarrjen ne kete aktivitet te prokurimit duke e vendosur

kete kerkese ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit. Ne shprehim shqetesimin tone lidhur me kete, pasi qe kjo eshte bere e qellimshme, duke bllokuar tregun, eliminuar konkurrencen dhe pamundesine e ardhjes se nje oferte me te mire dhe me te favorshme. Ku te gjitha aktet legjislative primare dhe sekondare te Prokurimit Publik, e ndalojne pergatitjen e Dosjes se Tenderit qe ne nje menyre favorizon ose diskriminon kunder nje ose me shume Operatoreve Ekonomik potencial.
Perdorimi i çfardo kriteri nga ana e autoriteteve kontraktuese qe eshte diskriminues per Operatoret Ekonomik eshte kriter jo-ligjor, ngase shkelet nje prej parimeve baze te LPP-se qe eshte Parimi - Barazia ne Trajtim/Jo-diskriminimi.

Kjo eshte e cekur decidivisht ne neni 18.9 i RRUOPP-se, ku percakton qarte se "Dosja e tenderit do te pergatitet ne ate menyre qe nuk:

- Kufizon konkurrencen ne mesin e OE, ose
- Diskriminon kunder ose vepron ne favor te nje ose me shume OE-ve.

Ne jemi detyruar qe me dt.01.12.2020, brenda afatit ligjor te parashtrojme kerkese per informacione shtese pranë autoritetit kontraktues, duke kërkuar nga autoriteti kontraktues qe te ndërmarrë veprimet ligjore te nevojshme dhe te eliminoje ketë kriter diskriminues dhe te panevojshume. Lidhur me kete kerkese per informacione shtese autoriteti kontraktues nxjerre vendim me dt. 03.12.2020, ku refuzon kerkesen tone si te pa bazuar, duke u arsyetuar se nuk eshte diskriminuese dhe qellimi eshte perzgjedhja e nje OE serioz. Keshtu qe, kjo nuk qendron aspak duke marre parasysh kur AK ka mundesi tjera te identifikoje OE serioz permes kritereve te pergjedhjeve te cilat nuk jane diskriminuese.

E aq me teper kur AK, por edhe OE jane te vetedijshem se paisjet, jane totalisht te sistemit te mbyllur dhe nuk lejon assesi asnje reagjent kompatibil perveç origjinalit. Rrjedhimisht thene, eshte e pamundur futja e reagjenteve tjere ne keto paisje dhe çdo ofertues me apo pa autorizim eshte i obliguar te ofroj/shes vetem reagjent origjinal dhe me cilesi te njejte, pasi qe te gjithe reagjentet do jene te certifikuara, te prodhuara, e te koduara vetem nga prodhuesi.
Andaj, çdo kerkese tjeter qe vendoset perveç certifikatave ISO dhe CE, do te vendoset vetem per qellime te diskriminimit dhe ofrimit te favoreve dhe assesi te nevojshme per te siguruar qe vetem OE qe posedojne aftesi te caktuara profesionale, financiare ose teknike do te marrin pjese ne konkurrence per kete kontrate, siç eshte diskriminuese ne kete rast edhe kerkesa juaj per Autorizimin.

Ngase, vetem nje OE qe e mban kete Kritere dhe si e vetme do te mund ta shes apo edhe ta autorizoj ndonje OE vetem per te krijuar nje konkurrenc FALLSE, dhe lene te kuptohet apo te paramendohet se çfare çmimesh do te mund te ofrohen kur lejohet vetem nje OE te ofertoje.

Edhe me nenin 51 te LPP-se, paragrafi 1 citon "Te gjitha kriteret e perzgjedhjes duhet te kufizohen vetem ne kriteret e nevojshme per te siguruar se vetem operatoret ekonomik qe posedojne aftesite e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike per ti permbushur kushtet e kontrates perkatese do te konsiderohen te kualifikuar per te marre nje kontrate te ti/le ose per marrjen e fteses per tenderim" Andaj, Komuna Prishtines duhet te perqendrohet vetem ne kritere te cilat jane te domosdoshme dhe jo diskriminuese.

Po ashtu edhe me nenin 4.4 te RRUOPP e obligon autoritetin kontraktues qe me Drejtesi/Mos-diskriminim - Te veprohet ne menyre te drejte gjate tere ciklit te prokurimit pa imponuar obligime te panevojshme ose pengesa per furnizuesit ose furnizuesit potencial. Te shmanget çdo trajtim qe

favorizon nje furnizues te caktuar ose furnizues potencial.

Nese, Komuna eshte e interesuar per cilesi dhe per kushte me te favorshme dhe te mos demtohet buxheti komunal ne mase te madhe, atehere duhet te hapet tregu, te largohet Kerkesen nr.2 dhe kerkoni vetem dokumente qe ju ofrojne dhe ju sigurojne cilesi siç jane çertifikatat ISO dhe CE, dhe mos te lejohet te krijohet monopol.

Edhe ashtu ne nenin 26 te Rregulloren dhe Udhezuesin Operativ per Prokurim Publik, eshte japur nje keshille per AK , pikerisht per kriteret te cilat jane te panevojshme - "Keshille: Shume AK i aplikojne kerkesat e nenit 68 dhe/ose 69 te LPP-se edhe per rastet kur nuk kane ndonje rendesi apo nevoje per tu deshmuar (p.sh. per aktivitetet te cilat kane per qellim furnizimin me mallra e te cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Ne keto aktivitete aplikimi i kritereve nga neni 68 dhe/ose 69 te LPP nuk eshte i arsyeshem perkundrazi eshte jo profesional dhe mund te shkaktoj probleme te panevojshme."

Lidhur me te gjitha keto parregullesi, Komuna e Prishtines , perveç shkeljeve te lartepermendura, ka bere edhe shkelje tjera te ketyre dispozitave te prokurimit publik, e te cilat jane:

Neni 1 i LPP-se, ju obligon qe te siguroj menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke percaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen, te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te permbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndermarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesioneret e puneve dhe organet publike qe zhvillojne, perfshihen, marrin pjese ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose qe perfshihen ose kane te bejne me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 i LPP-se. Komunen e Prishtines e obligon qe te siguron qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyren me ekonomike, njekohesisht duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit. Dhe jo te veprohet edhe me tutje me këto kerkesa dhe ne kete menyre, ku ju, si autoritet kontraktues rrezikoni seriozisht te demtoni buxhetin sepse ne momentin kur kufizohet konkurrenca per OE te caktuar, atehere mundesia eshte shume e madhe qe te ofrohen çmime shume me te larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet te arrihet qellimi i LPP-se.

Neni 7 i LPP-se, Eshte parimi baze i Prokurimit Publik, ku ceke se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtoje operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente. Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk do te ekzekutoje asnje aspekt te aktivitetit te prokurimit ne nje menyre qe redukton apo eliminon konkurrencen ne mes te operatoreve ekonomik ose qe diskriminon ne dem ose ne te mire te nje ose me shume operatoreve ekonomik.

Neni 4.1 i RRUOPP-se, citon "AK gjate udheheqjes se procedurave te prokurimit jane te obliguar te marrin masa te nevojshme per te siguruar trajtim te barabarte dhe jo-diskriminim ne mesin e Operatoreve Ekonomik."
Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kerkojme nga OSHP qe te merr::

VENDIM

APROVOHET: Ankesa e OE Ntsh "AtomMed" si e bazuar
ANULOHET: ky aktivitet i prokurimit apo te ndryshohen kriteret e perzgjedhjes dhe te veprohet

konform nenit 53.7 te LPP-se.
Gjithashtu, kerkojme nga ju qe te detyrohet dhe te udhezohet AK, qe te mos behen kerkesa favorizuese dhe diskriminuese, te largohet Kerkesa Nr.2 "Nje specialist te trajnuar per montim dhe venie ne funksion te aparatures per D-Dimer,dhe kerkesa per nje Inxhiner te trajtuar per servisim te aparatures per D-Dimer"dhe te vendosen vetem kerkesa qe jane te domosdoshme dhe te nevojshme si dhe konform dispozitave ligjore te LPP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme për furnizime me material medicional ne vlere minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).
2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një specialist të trajnuar për montim dhe vënie në funksion të aparaturës për D-Dimer; b) Një Inxhinier te trajnuar për servisim të aparaturës për D-Dimer
3. OE duhet te jete i licencuar per Importim te materialeve mjekësore
4. OE duhet te ofroj katalogun per produktin e ofertuar

Dëshmia dokumentare

1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve.
2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për furnizmet e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Certifkata të lëshuara nga prodhuesi se janë të certifikuar për serivisim të aparaturës.
3. Licenca valide për importimin e materialeve mjekësore e lëshuar nga A.K.P.M.
4. Katalogu i produktit me te cilat oferton - i nënshkruar dhe i vulosur

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "N.T.SH. Atom - Med" - FERIZAJ

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të dërguar nga AK me datë 30.11.2020.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Pretendimi ankimor ka të bëjë me kriteret e përzgjedhjes, përkatësisht kriterin të cilin AK e ka vendosur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit *"2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një specialist të trajnuar për montim dhe vënie në funksion të aparaturës për D-Dimer; b) Një Inxhinier te trajnuar për servisim të aparaturës për D-Dimer"*

AK në dosjen e tenderit tek *"Aneksi 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme"* nuk ka paraqitur të dhëna teknike, përveç deklaratës *"Sipas Paramasës"*. Të dhënat më specifike mbi furnizimet janë gjetur tek dokumenti *"Përshkrimi i Çmimeve"* dhe dokumenti *"Sqarimet e DT per D-Dimer"* i ngritur në sistemin e E-Prokurimit nga AK me datë 03.12.2020. Në bazë të këtyre dokumenteve dhe përshkrimit të lëndës së kontratës, AK ka kërkuar që të furnizohet me "Reagjent" dhe jo ndonjë aparaturë të veçantë. Po ashtu, në dokumentet tenderike në sistemin e E-Prokurimit nuk është gjetur ndonjë kërkesë apo ndonjë pozicion i veçantë tek përshkrimi i çmimeve që kërkon shërbim shtesë për instalimin e ndonjë

aparature të veçantë apo montimin e këtyre reagjentëve në ndonjë aparaturë nga OE. Prandaj, kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional të cilat janë vendosur nga AK ku kërkohet specialist dhe inxhinier për montim dhe servisim të aparaturës dhe ndërkohë lënda e kontratës, është furnizimi me reagjent dhe jo furnizim me ndonjë aparaturë përkatëse, nuk është në harmoni me Nenin 51-Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, pika 3 e LPP-së ku thuhet se: *"Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse."* Prandaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Gjithsesi, rekomandohet që paneli shqyrtues të caktojë, një ekspert teknik të fushës mjekësore, në mënyrë që të shqyrtojë nëse ka ndonjë ndërlidhje eventuale të përdorimit të këtij kriteri të përzgjedhjes.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të rishikohen kriteret e përzgjedhjes dhe të jenë proporcionale me lëndën e kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – "N.T.SH. Atom - Med" - FERIZAJ